

Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë i ka dërguar letër autoritetit më të lartë fetar në Egjipt, shejhul Az'har-it, hirësisë së tij, Ahmed Muhamed Ahmed et-Tajib, të cilit i ka kërkuar që të përdorë autoritetin e tij te qeveria e Egjiptit për ta përkrahur pranimin e Kosovës në UNESCO.

Siç bëhet e ditur nga një njoftim i Bashkësisë Islame të Kosovës, në letrën drejtuar Shejhul Az'harit, myftiu Tërnavë ia rikujton të kaluarën e Kosovës, si dhe gatishmërinë e vendit tonë për të qenë pjesë e institucioneve ndërkombëtare.

“Kosova është e gatshme dhe ka të gjitha kapacitetet që t'i marrë të gjitha përgjegjësitë që i takojnë në forumet dhe institucionet ndërkombëtare. Për ne pranimi në UNESCO është i një rëndësie të veçantë, sepse do të përfitonim përvojën, përkrahjen dhe mbështetjen për trajtim, ruajtje dhe promovim të trashëgimisë sonë shekullore, e cila më së miri shpreh dhe manifeston vlerat qytetëruese të popujve tanë. Ju lutem, i nderuar shejh, që të përdorni autoritetin tuaj te qeveria e Egjiptit, për të përkrahur anëtarësimin e Kosovës në UNESCO, në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, më 9 nëntor 2015”, ka shkruar Myftiu Tërnavë.

Sipas njoftimit në fjalë, po me letër për përkrahjen e Kosovës për anëtarësim në UNESCO, myftiu Tërnavë i është drejtuar edhe sekretarit gjeneral të Organizatës për Bashkëpunim Islamik, Ijad Medeni, nga i cili po ashtu ka kërkuar përdorimin e autoritetit të tij te shtetet anëtare të Konferencës Islamike për ta përkrahur dhe mbështetur anëtarësimin e Kosovës në UNESCO.
/Telegrafi/